

Në bazë të nenit 23 të Vendimit për themelimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar Transmetuesi lokal publik „Radio Televizioni i Ulqinit“ („Fl. Zyr. MZ – dispozitat e komunës“, nr. 38/11) dhe nenit 42, paragrafi 1, pika 38 të Statutit të Komunës së Ulqinit („Fl. Zyr. MZ – dispozitat e komunës“, nr. 5/07, 9/09 dhe 16/11), Kuvendi i Komunës së Ulqinit në mbledhjen e mbajtur, më 25.03. 2019 ka nxjerrë

AKTVENDIMIN

PËR EMËRIMIN E KËSHILLIT TË TRANSMETUESIT LOKAL

PUBLIK „RADIO TELEVIZIONI – ULQIN“

I. Emërohet Këshilli në përbërje:

1. Ardita Rama – kandidat i Institucionit publik nga fusha e kulturës,
2. Bilal Nikeziq – kandidat i institucioneve të arsimit,
3. Hajrudin Çausi – kandidat i klubeve sportive dhe shërbimeve publike nga fusha e sportit,
4. Xhemal Peroviq – kandidat i organizatave joqeveritare nga fusha e mediave, të drejtave dhe lirive të njeriut dhe të drejtave të personave me invaliditet,
5. _____ - kandidat i shoqërive ekonomike dhe sipërmarrësve.

II. Me hyrjen në fuqi të këtij Aktvendimi, pushon Vendimi për emërimin e Këshillit të Transmetuesit lokal publik „Radio Televizioni i Ulqinit“ („Fl. Zyr. MZ – dispozitat e komunës“, nr. 14/2012 i datës 27. 04. 2012).

III. Ky Vendim hynë në fuqi ditën e tetë nga dita e publikimit në „Fletoren zyrtare të Malit të Zi – dispozitat e komunës“.

KUVENDI I KOMUNËS SË ULQINIT

Numër: 02-60/19-14
Ulqin, më 25.03.2019

Kryetari
Dr. Ilir Çapuni, d.v.